



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0018345-1/26 dt. 20.04.2026

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa
Mbledhja e 4-të

Koha: 20.04.2026 ora 11:00

Vendi: Salla e Mediave

Të pranishëm: Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Majlinda Kurti, Igballe Islami,
Valon Brahimi, Erseka Barani, Kushtrim Zeneli dhe Visar Syla

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi i cili theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11, të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, për sot kam thirrur mbledhjen e katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa me rendin e ditës të paraparë me thirrje.

Në vazhdim Kryesuesi theksoi se në Zyrën e Kuvendit kanë ardhur edhe 4 kërkesa të OJQ-ve për përkrahje financiare: Kërkesat e shoqatave të dala nga lufta për mbështetje financiare:

- Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë
- Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë
- Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë, dhe
- Kërkesa e Lidhjes së Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës – Dega në Mitrovicë.

Po ashtu kemi edhe Propozim vendimin për subvencionimin e fëmijëve me autizëm, i cili për shkak të një lëshimi timin ka mbetur pa u përfshirë në rend dite.

Hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Ramadan Beshiri: Propozoj që në rend dite të hyjë edhe Propozim vendimi për vendosjen e pllakës përkujtimore heroit Driton Veliu, kjo pllakë do të vendoset në vendin ku ka rënë, nëse jeni të pajtimit materialin për këtë pikë ua sjellim gjatë ditës.

Nënkryetari Enis Osmani: Propozoj që në rend dite të hyjë edhe Propozim vendimi për caktimin e selisë së përhershme të Muzeut të qytetit të Mitrovicës.

Valon Brahim: Do ta ngrejë një çështje që ka të bëjmë me Drejtorinë e Arsimit, kam pritur se në mbledhje do të jetë i pranishëm edhe Drejtori i Arsimit. Ka mungesë të madhe të profesorëve në shkollat e mesme, ndërsa orët mësimore shpesh zhvillohen në mënyrë të çrregullt dhe me ngarkesë të madhe në shkollat tona. Këtë çështje ia kam adresuar DA-së, por nuk kam marrë asnjë përgjigje nga zyra e tij. Ne si Komitet për Politikë dhe Financa, duhet të angazhohemi më shumë për këtë problem, sepse trajtimi i kësaj situatë është në interes të përgjithshëm dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në vend. Unë mendoj se të gjithë jemi në dijeni për situatën nëpër shkolla, por edhe drejtorët duhet të japin llogari dhe të sigurojnë që shkollat të vizitohen dhe të monitorohen rregullisht. Duke lënë anash problemet e infrastrukturës fizike, të cilat dihet se janë të shumta, çështja e zëvendësimit të personelit duhet të trajtohet me prioritet. Kjo situatë vërehet në shkollën e mjekësisë, të ekonomisë, në gjimnaz dhe në shkolla të tjera fillore dhe të mesme. Në këto shkolla, shpesh ndodh që dy ose tri orët e fundit të mos mbahen fare. Kam edhe rast personal: nipi im shpesh i përfundon orët më herët dhe kthehet në shtëpi pa zhvilluar mësimin e plotë. Në këtë gjendje të arsimit, është e vështirë të thuhet se gjithçka është në rregull.

Kryesuesi Safet Kamberi: Çështjen që e ngriti z. Brahim për gjendjen në arsim, të jetë konkluzion i KPF-së që për mbledhjen e radhës Drejtoria e Arsimit të sjellë një Raport mbi gjendjen në arsim.

Në vazhdim Kryesuesi propozoi që pikë e 7-të e rendit të ditës të jetë Propozim vendimi për subvencionimin e fëmijëve me autizëm.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht (7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime) u pajtuan që pikë e 7-të e rendit të ditës të jetë Propozim vendimi për subvencionimin e fëmijëve me autizëm.

Kryesuesi propozoi që pikë e 8-të e rendit të ditës të jetë: Kërkesat e shoqatave të dala nga lufta për mbështetje financiare:

- 8.1 Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë,
- 8.2 Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë,
- 8.3 Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht (7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime) u pajtuan që pikë e 8-të e rendit të ditës të jetë: Kërkesat e shoqatave të dala nga lufta për mbështetje financiare.

Kryesuesi propozoi që pikë e 9-të e rendit të ditës të jetë: Kërkesa e Lidhjes së Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht (7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime) u pajtuan që pikë e 9-të e rendit të ditës të jetë: Kërkesa e Lidhjes së Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare.

Kryesuesi propozoi që pikë e 10-të e rendit të ditës të jetë: Propozim vendimi për caktimin e selisë së përhershme të Muzeut të qytetit të Mitrovicës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht (7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime) u pajtuan që pikë e 10-të e rendit të ditës të jetë: Propozim vendimi për caktimin e selisë së përhershme të Muzeut të qytetit të Mitrovicës.

Kryesuesi propozoi që pikë e 11-të e rendit të ditës të jetë: Propozim vendimi për vendosjen e pllakës përkujtimore heroit Driton Velu.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht (7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime) u pajtuan që pikë e 11-të e rendit të ditës të jetë: Propozim vendimi për vendosjen e pllakës përkujtimore heroit Driton Velu.

Në vazhdim Kryesuesi propozoi rendin e ditës si në vijim:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

2. Draft-Rregullorja për plotësim të Rregullores Nr. 01/2022 Për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës Komunale
3. Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake të pashfrytëzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprahe, në vitin 2026
4. Propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të komiteteve konsultative, komiteteve tjera, kryetarëve të këshillave lokalë dhe komisioneve ad hoc të formuara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2026
5. Propozim vendim për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02/06-4136/10 dt. 02.08.2010
6. Raport financiar për periudhën janar-mars 2026
7. Propozim vendim për subvencionimin e fëmijëve me autizëm
8. Kërkesat e shoqatave të dala nga lufta për mbështetje financiare:
 - 8.1 Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë
 - 8.2 Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë
 - 8.3 Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë
9. Kërkesa e Lidhjes së Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare
10. Propozim vendim për caktimin e selisë së përhershme të Muzeut të qytetit të Mitrovicës
11. Propozim vendim për vendosjen e pllakës përkujtimore heroit Driton Veliu

Rendi i ditës u miratua unanimit (7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime).

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e tretë e KPF-së (e jashtëzakonshme) u miratua unanimit (7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime).

Pika 2

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi para se të hapë diskutimin lidhur me Draft-Rregulloren për plotësim të Rregullores Nr. 01/2022 Për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës Komunale, për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Kryetarit të Komisionit për hartimin e Draft-rregullores z. Bedri Muja.

Kryetari i Komisionit për hartimin e Draft-rregullores për plotësim të Rregullores Nr. 01/2022 Për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës Komunale z. Bedri Muja, në pika të shkurtra tregoi të gjitha procedurat që janë ndjekur për hartimin e kësaj draft-rregulloreje.

Në vazhdim Kryesuesi i mbledhjes hapi diskutimin.

Igballe Islami: Së pari e përgëzoj Komisionin për punën e bërë e po ashtu e përgëzoj edhe Ekzekutivin për bashkëpunimin me ne, Draft-rregullorja është korrigjuar sipas kërkesave tona, ajo çka ne kemi pasë vërejtje ka qenë shtimi i një sektori pas konsultimit publik, kjo është tash është rregulluar, prandaj jemi në rregull.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Draft-Rregulloren për plotësim të Rregullores Nr. 01/2022 Për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës Komunale.

Rezultati i votimit: 7-për, 0-kundër, 0-abstenime.

Draft-Rregullorja për plotësim të Rregullores Nr. 01/2022 Për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës Komunale u miratua unanimit dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim vendimin për bartjen e të hyrave vetanake të pashfrytëzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake, në vitin 2026.

Igballe Islami: Bartja e të hyrave realisht është vlerë që bëhet pikërisht me tejkalimin e planit të të hyrave, bazuar në Ligjin e Buxhetit, por edhe Ligjin për Financat Publike dhe Përgjegjësitë, prioritet duhet t'u jepet përmbushjes së obligimeve kontraktuale. Ne me material kur e kemi pranuar, nuk kemi pranuar fare arsyetim. Si dëshmi, është një material i vitit të kaluar kur bartja e të hyrave është sjellë në Komitet me 51 faqe për secilin program, ashtu siç kërkohet nga Ministria e Financave. Megjithatë, për ne nuk është e domosdoshme me i pa kontratat mirëpo është procedurë që kërkohet nga MF-ja, që çdo bartje e të hyrave të jetë e mbuluar edhe me obligime kontraktuale, përkatësisht kërkohet kontrata mbi të cilën bëhet bartja e të hyrave. Po ashtu, kemi pranuar një arsyetim me e-mail nga Sekretaria e Kuvendit, por nuk është e qartë kush e ka dërguar dhe kush e ka përgatitur atë arsyetim. Ai arsyetim është i vitit 2025, thirret në ligjin e vitit 2025, është shkresë që ne kemi proceduar për Kuvend. Te pjesa e parë mund të shihet se thirret se bartja e të hyrave nga nënprogrami i arsimit po barten në nënprogramin e arsimit, sepse kështu e kërkon Ligji i buxhetit, ndërsa ju nuk keni bartje të të hyrave fare në nënprogramin e arsimit. Po dëshmohet që është shkresa e jonë, janë përmirësuar, por nuk e ka marrë mundin minimal me e përditësuar bazën ligjore apo me e hequr pjesën ku përmenden të hyrat e dedikuara për shëndetësi dhe arsim. Sinqerisht, është shqetësuese që nuk po përcillen këto detaje. Sa i përket bartjes së të hyrave dhe arsimit që kemi pranuar, me të vërtetë të krijohet përshtypja sikur po aprovohet një buxhet i ri, ndërsa ky nënprogram ka mjete financiare për mbulimin e obligimeve kontraktuale të cilat i ka brenda tij. Bartja e tyre nuk po bëhet në mirëqenien sociale, qytetarët e Mitrovicës tash e disa vite kanë përfituar ndihmë konkrete nga komuna, në vlerë 100 euro, me qenë se Komuna e Mitrovicës edhe nëse ka rënie prej 2%, vazhdon të prijë me skemën e asistencës sociale, kështu që përderisa nuk bëhet bartja e të hyrave iu pamundësohet qytetarëve me përfituar shtesën të cilën tash e sa vite e përfitojnë. Te arsyetimi, sa i përket bartjes së mjeteve të menaxhimi i fatkeqësive që të barten 120 mijë euro për trajtimin e qeneve endacak, në nënprogramin e zhvillimit ekonomik, konsideroj se kjo çështje është trajtuar me Ligjin e Buxhetit. Mjetet janë të ndara në nënprogramin e menaxhimit të fatkeqësive, në vlerë 360 mijë euro, dhe gjatë aprovimit të buxhetit është përmendur se këto mjete lidhen edhe me kontratat për trajtimin e qeneve endacakë. Prandaj, bartja e mjeteve në programin e zhvillimit ekonomik nuk është e nevojshme. Gjithashtu, nëse në programin e menaxhimit të fatkeqësive natyrore barten mjete për blerjen e pajisjeve për zjarrfikësit është e panevojshme, atëherë këto duhet të vendosen drejtpërdrejt në nënprogramin për zjarrfikës dhe inspektime, aty ku janë të nevojshme. Është premtuar se do të ketë subvencionim për familjet që kanë pësuar nga subvencionimet, nuk janë përfshirë, kështu që është mirë të rishikohet kjo bartje, të shikohet mundësia që kjo bartje të plotësohet me arsyetimet e nevojshme, pra a do të ketë subvencionim për familjet që kanë pësuar nga vërshimet dhe a do të ketë subvencionim për familjet të cilat janë me asistencë sociale.

Gazmend Gjoshaj: Në takimin e Kryetarit e Komunës dhe drejtorët e drejtorive e kemi paraparë se ku është më e nevojshme me u nda këto mjete.

Erseka Barani: Pajtohem me Igballen lidhur me arsyetimin që e kemi pranuar me e-mail se nuk është i përpiluar mirë, ndërsa sot unë e kam plotësisht të qartë se ku do të dedikohen këto mjete, unë mendoj se është prioritet i secilit drejtor që mjetet që barten nga të hyrat e vitit paraprak të orientohen nëpër projektet ku ata i kanë edhe prioritet.

Kushtrim Zeneli: Për hir të korrekhtësisë kërkoj që kjo pikë kur të vije në Kuvend të vije me arsyetimin që u cekë, unë dua të ndërlidhem me bartjen e të hyrave ku po preken direkt qytetarët siç është siguria publike, trafiku, kolegeja e përmendi edhe kontratën për shërbime emergjente, prandaj të jetë arsyetimi edhe përse po barten këto mjete. Ne e dimë që kemi pasur një kontratë tri vjeçare, për 36 mijë euro për nevojat emergjente dhe është shpenzuar për 1 muaj, pra le të tregohet edhe ku kanë shkuar këto mjete. Po ashtu të ipet arsyetimi edhe pse këto mjete po barten për trajtimin e qeneve endacak e jo diku tjetër, pra të kemi një raport pse këto mjete do të barten aty.

Igballe Islami: Realisht, nuk jam këtu për ta mbrojtur punën e ekzekutivit të kaluar. Unë këtu jam në rolin e asamblistës. Fillimisht, ne nuk po diskutojmë qysh janë shpenzuar mjetet, mirëpo po diskutojmë qysh po shkojnë mjetet, qysh po bëhet bartja e të hyrave. Tash, nëse doni me e ditë pse unë po mendoj se nuk është në rregull dhe pse po devijohet planifikimi i buxhetit, është pikërisht pse po barten mjetet në zhvillim ekonomik e nuk po vazhdon aty ku është planifikuar. Unë e di që lënda për trajtimin e qenve endacak është në OSHP, unë vetëm po kërkoj pse nuk është iniciuar aty ku është bërë planifikimi i buxhetit. Pa marrë parasysh nëse ndërrohet ekzekutivi, në ligj duhet me u bazuar dhe duhet respektuar prej secilit që e merr pushtetin, puna duhet me vazhduar në kontinuitet. Ligji i buxhetit është aprovuar në Kuvend të Kosovës, dhe mjetet janë dedikuar aty, unë vetëm po kërkoj që të respektohet Ligji i buxhetit.

Naser Muja: Desha të ndërlidhem me çështjen që u ngrit për trajtimin e qenve endacak, ne nuk jemi në dijeni se ka pasur planifikim për këtë çështje në Drejtorinë e emergjencave, nëse këto mjete janë në Drejtorinë përkatëse atëherë do barten pa telashe dhe këto mjete do të dedikohen diku tjetër pa asnjë problem.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim vendimin për bartjen e të hyrave vetanake të pashfrytëzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake, në vitin 2026.

Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të pashfrytëzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake, në vitin 2026 u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 4

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim vendimin për kompensimin e anëtarëve të komiteve konsultative, komiteve tjera, kryetarëve të këshillave lokale dhe komisioneve ad hoc të formuara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2026.

Igballe Islami: Te baza ligjore ku thirret në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019 Për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanimet dhe lagjet urbane, dhe nenin 13 me të cilin e keni iniciuar, aty ceket financimi i aktiviteteve, unë vlerësoj se kjo duhet bazuar në nenin 12 ku ceket kompensimi i kryetarëve të këshillave lokale, dhe një pjesë që e keni potencuar e që nuk është në përputhje me Udhëzimin Administrativ të MAPL-së, është kushtëzimi i pagesës së kryetarëve të këshillave lokale pa pjesëmarrjen e Kryetarit, unë mendoj që duhet të bazoheni në nenin 12 nëse procedojmë tutje, e me nenin 12 përcaktohet qartë se paguhet për 6 mbledhje brenda vitit dhe paguhet në shumën ekuivalente të komiteve të përhershme e jo 50 €.

Kryesuesi i Kuvendit Safet Kamberi: Ne së bashku me Sekretarinë e Kuvendit e kemi bërë një llogari se cila mundet me qenë shuma, diku mbi 40.000, e që ne nuk kemi mundësi me i paguar, e mira e kësaj është testimi i ligjshmërisë së saj për me vazhduar tutje, nëse ju mendoni me e rritë këtë shumë kjo ka me qenë ngarkesë për buxhetin e në veçanti për buxhetin e Kuvendit, nuk ka pasë planifikim për këtë çështje, por me bartjen e të hyrave me mirëkuptim kemi arritur t'i ndajmë 20.000 €.

Kushtrim Zeneli: Është mirë që është bërë kjo iniciativë për pagesën e këtyre komisioneve, atë që kisha dashur me e sugjeruar dhe me e përmirësuar është që nga ky vendim të hiqen kryetarët e këshillave lokale për arsye se neni 12 i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2019 Për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanimet dhe lagjet urbane e specifikon e Kryetarët e këshillave paguhet në shumën ekuivalente të komiteve të përhershme, prandaj nuk mundet një anëtar i komiteve me u paguar 50 € për mbledhje ndërsa Kryetari i Këshillit lokal të paguhet në shumën që paguhet anëtarët e komiteve të përhershme.

Ramadan Beshiri: E kërkoja fjalën me arsyë, sepse kam qenë kryetar i Këshillit të Lagjes Ilirida, lagja më e madhe, dhe kemi bashkëpunuar me të gjithë kryetarët e këshillave të lagjeve dhe fshatrave gjatë legjislaturës së z. Bedri Hamzës për të arritur këtë pagesë, mirëpo nuk është realizuar në kohën e qeverisjes së tij, si rezultat i Ligjit për paga të vitit 2023. Sa i përket kësaj, ne kemi mbajtur edhe

takime dhe jemi takuar edhe me DEMOS-in, një organizatë që e ka paraparë, përmes rishikimit të legjislacionit, që Ligji i pagave të mos i prekë përfaqësuesit e këshillave të lagjeve dhe fshatrave, sepse ata kryejnë shërbime dhe nuk janë me pagë. Kështu që, këta përjashtohen nga ky ligj, dhe kryetarët e këshillave të lagjeve dhe fshatrave duhet të paguhen bazuar në udhëzimin për kompensimin e anëtarëve të komisioneve obligative, i cili ka qenë 50 euro. Kjo pagesë është bërë në kohën e qeverisjes së z. Agim Bahtirit. Ndërsa tani, me ndryshimet që kanë ndodhur në Ligjin për pagën minimale, kjo shumë ka shkuar në 183 euro, që i bie për gjashtë mbledhje brenda vitit, kryetarëve të këshillave të lagjeve dhe fshatrave u takojnë 1,098 euro, ndërsa në total, shuma për të gjithë kryetarët e këtyre këshillave shkon mbi 30 mijë euro në vit. Natyrisht, ata kanë detyrimin të mbajnë mbledhje, të hartojnë procesverbale dhe t'i dorëzojnë ato te kryesuesi i Kuvendit, duke i arsyetuar mbledhjet e mbajtura. Gjithsesi, ky është një mekanizëm shumë i rëndësishëm për Komunën e Mitrovicë, dhe ne e dimë se, edhe sipas Kartës Evropiane dhe agjendës evropiane, këta përfaqësues kanë një rol shumë të rëndësishëm. Po ashtu, Kryesuesi na ka informuar se, bazuar në praktikën e mëparshme, kanë qenë dy komuna: Kaçanik dhe Lipjan, ku njëra ka vepruar përmes subvencioneve, ndërsa tjetra përmes mallrave dhe shërbimeve. Ne, si kryetarë të këshillave të lagjeve dhe fshatrave, u jemi drejtuar zyrtarëve të MAPL-së, të cilët kanë thënë se kjo kategori realizohet më së miri, ligjërisht kryhet përmes kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, pasi që ne kryejmë shërbime. Prandaj, mendoj se kjo ka bazë ligjore dhe mund të procedohet më tej pa problem.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim vendimin për kompensimin e anëtarëve të komiteteve konsultative, komiteteve tjera, kryetarëve të këshillave lokale dhe komisioneve ad hoc të formuara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2026.

Rezultati i votimit: 6 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Propozim vendimi për kompensimin e anëtarëve të komiteteve konsultative, komiteteve tjera, kryetarëve të këshillave lokale dhe komisioneve ad hoc të formuara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2026 u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 5

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim vendimin për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02/06-4136/10 dt. 02.08.2010.

Valon Brahimi: Unë e vlerësoj se ky vendim, edhe pse në parim e kemi votuar që të kalojë si pikë e rendit të ditës, megjithatë, ky propozim nuk është dashtë me ardhë hiq për shqyrtim. Ky është një vendim që prek më shumë rreth 260 zyrtarë të Komunës. Vlerësoj se cenohet një e drejtë e tyre ligjore dhe më themelore, kur dihet fakti se kategoritë e tjera i kanë realizuar këto të drejta. Në vlerësojmë se propozim-vendimi në fjalë i propozuar nga Drejtori i Drejtorisë së Financave, e kuptojmë që mund të lidhet me objektivat strategjike të kryetarit, por duhet të kemi parasysh se, organet e vetme të autorizuara për interpretim të ligjit janë gjykatat. Në këtë rast, kemi të paktën dy akt gjyqësorë ku palët kanë marrë përgjigje pozitive prej gjykatës. Këtë mundem me e dëshmuar edhe me kopje fizike, por mundem me e dëshmuar edhe me shkresën e avokatit të komunës, i cili e konfirmon të njëjtën, e cila është pjesë e materialit përcjellës, ku konfirmohet se gjykata ua ka njohur të drejtën për realizimin e kësaj të drejte. Prandaj, do të ishte gabim i madh nëse Kuvendi do ta shfuqizonte këtë vendim, sepse do të binim ndesh me vendimet e gjykatës. Nëse nuk i respektojmë vendimet gjyqësore, atëherë shtrohet pyetja: a jemi shtet ligjor apo jo? Një kërkesë e Thesarit jo domosdoshmërisht është më e besueshme se një vendim gjyqësor. Në fund të fundit, të gjitha çështjet administrative përfundojnë në gjykatë, dhe është gjykata ajo që jep verdiktin përfundimtar. Si anëtar i KPF-së dhe si anëtar i Kuvendit të Komunës, jam kundër këtij propozim-vendimi. U bëj thirrje të gjithë anëtarëve që ta shqyrtojnë me kujdes këtë çështje. Nuk është çështje personale dhe nuk ka të bëjë me atë se kush e ka propozuar, kushdo që ta kishte sjellë, do ta kundërshtoja njësoj. Qëndrimi im bazohet në mbrojtjen e një të drejte ligjore të zyrtarëve komunal. Madje, konsideroj se edhe Thesari do të duhej të kërkonte interpretim nga departamenti ligjor i Ministrisë së Financave përpara se të vepronte. Kërkoj nga të gjithë që të veprojnë sipas ndërgjegjes dhe të mos e mbështesin këtë

vendim. Mendoj se kjo pikë e rendit të ditës duhet të shtyhet ose të hiqet përkohësisht, derisa të analizohet më thellë, sidomos nga aspekti ligjor, në mënyrë që të mos bëjmë gabime. Vendimet e gjykatave kanë fuqi detyruese. Në këtë rast, gjykata ka konstatuar se palëve u takon kjo e drejtë, ndërsa komuna nuk e ka realizuar atë për një kohë të gjatë (që nga viti 2010). Për këtë arsye, palët janë detyruar t'i drejtohen gjykatës, e cila jo vetëm ua ka njohur të drejtën, por edhe ka obliguar komunën ta zbatojë atë. Nëse ne, si anëtarë të Kuvendit Komunal, votojmë një vendim që ua cenon këtë të drejtë ligjore, atëherë kjo është e papranueshme. Prandaj, unë e kundërshtoj këtë propozim-vendim në tërësi dhe kërkoj nga të gjithë anëtarët që ta shqyrtojnë me seriozitet.

Gazmend Gjoshaj: Ne kemi marrë një përgjigje nga Thesari ku ky vendim është në kundërshtim me tri ligjet që ata i kanë cekur: Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin nr. 03/L-049 dhe Ligjin nr. 08/L-196. Ata gjithashtu theksojnë edhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese me numër KO79/23, duke veçuar se, pavarësisht pavarësisë funksionale, organizative dhe buxhetore, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës i nënshtrohen detyrimit për zbatimin e ligjeve relevante në lidhje me menaxhimin e financave publike. Kjo do të thotë se, pavarësisht që vendimi mund të jetë marrë në mënyrë të drejtë, nëse nuk është paraparë në buxhetin e vitit përkatës, atëherë konsiderohet i pazbatueshëm.

Valon Brahimaj: Ne nuk po kërkojmë për dy arsye për ta çuar çështjen më tej. E para, nuk po kërkojmë që qytetarët t'i realizojnë të drejtat e tyre përmes përfaqësimit nga avokatët, është më e arsyeshme që komuna të gjejë një zgjidhje përmes ndërmjetësimit. Dhe e dyta, ne po i referohemi një aktgjykimi të muajit korrik 2025, që nuk ka as gjashtë muaj që është nxjerrë. Thuhet: Aktgjykim për shkak të mos padëgjueshmërisë (mos bindjes), aprovohet në tërësi padia e paditësit ashtu që detyrohet e paditura, Komuna e Mitrovicës së Jugut që paditet, që në emër të kompensimit të shujtave ushqimore për periudhën 01.01.2022..., pra për 12 muaj t'ua aprovoj këtë të drejtë, prandaj, unë prapë po e theksoj se jam kundër këtij vendimi, nuk dua t'iu cenohet një e drejtë e fituar me gjyq zyrtarëve të Komunës.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim vendimin për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02/06-4136/10 dt. 02.08.2010.

Rezultati i votimit: 4 për, 2 kundër dhe 0 abstenime.

Propozim vendimi për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02/06-4136/10 dt. 02.08.2010 u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 6

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Raportin financiar për periudhën janar-mars 2026.

Igbal Islami: Përderisa po flasim në komitet, unë vlerësoj se kjo i kontribuon procesit. Çështjet politike duhet të diskutohen në Kuvend. Drejtor, fillimisht rreth 45% ka rënie të të hyrave, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (janar-mars 2025), inkasimi ka qenë rreth 830 mijë euro, ndërsa tani është 458 mijë euro. Pjesën tjetër mund ta diskutojmë në Kuvend; mua më intereson kryesisht çështja e pagave dhe shtesave. Keni theksuar se ka ekzekutim të vendimeve gjyqësore në vlerë prej 3,796 euro (faqe 7), ndërsa në fund të raportit financiar thuhet se nuk ka pasur ekzekutim të vendimeve gjyqësore. Për ta përmbledhur: Ligji i Buxhetit për vitin 2026 e ndalon ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në kategorinë e pagave. Prandaj shtrohet pyetja: a ka pasur apo jo ekzekutim në këtë kategori, siç është potencuar në tabelën 2.3, apo nuk ka siç keni thënë në fund të raportit, dhe nëse ka, atëherë duhet të shqyrtohet, sepse ligjërisht nuk lejohet. Përderisa Ligji i buxhetit e ndalon këtë lloj shpenzimi, nuk besoj se Ministria e Financave do të lejonte realizimin e tij, pasi është e ndaluar me ligj. Një tjetër çështje e çuditshme dhe befasuese është të kesh obligime financiare në kategorinë e shpenzimeve komunale, ku Komuna e Mitrovicës ka suficit në shpenzimet komunale për herë të parë shikuar me raportet e para sa viteve rreth 57 mijë euro janë obligime komunale. Po ashtu, vërehet problem me ndërprerjet e energjisë elektrike, shpesh për shkak të pagesave për ndriçim publik.

Gazmend Gjoshaj: Është e vërtetë që ka pasur të hyra më të ulëta, mirëpo problemi qëndron te fakti se platforma e tatimit në pronë ka qenë jashtë funksionit për rreth një muaj. Për këtë arsye, nuk ka qenë e mundur as të shtypen faturat dhe as të shpërndahen faturat e reja. Megjithatë, një pagesë është realizuar në fund, me datën 31 mars, por kjo nuk lidhet me raportin e BQK-së dhe nuk është pjesë e këtij raporti. Gjithashtu, për herë të parë ka ndodhur që një operator i vetëm të kryejë pagesë në vlerë prej 165 mijë eurosh. Kjo nuk ka ndodhur asnjëherë më parë.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Raportin financiar për periudhën janar-mars 2026.

Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Raporti financiar për periudhën janar-mars 2026 u miratua unanimitisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 7

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim vendimin për subvencionimin e fëmijëve me autizëm.

Valon Brahimi: Mirë është që kjo çështje është adresuar në KPF dhe do të procedohet në Kuvend. Kam pasur edhe disa pyetje për t'ia drejtuar Kryetarit, por nuk është këtu prezent. Është mirë që Kryetari, kur del me qëndrime publike, të deklarojë se do ta propozojë këtë subvencionim në Kuvend, sepse këto mjete i ndan Kuvendi dhe jo Kryetari. Vërejtja ime është me qenë korrekt në komunikim me publikun.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim vendimin për subvencionimin e fëmijëve me autizëm.

Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Propozim vendimi për subvencionimin e fëmijëve me autizëm u miratua unanimitisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 8

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Kërkesat e shoqatave të dala nga lufta për mbështetje financiare.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Kërkesën e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare.

Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kërkesa e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare, u miratua unanimitisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi vuri në votim Kërkesën e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare.

Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kërkesa e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare, u miratua unanimitisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi vuri në votim Kërkesën e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare.

Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kërkesa e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare, u miratua unanimitisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 9

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi para se të hap diskutimin lidhur me Kërkesën e Lidhjes së Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare, theksoi

se kërkesa ka të bëjë me një shumë më të madhe se sa që na lejohet me i mbështetë, prandaj unë propozoj që kjo shoqatë të mbështetet financiarisht sikurse edhe shoqatat tjera me shumën prej 500.00 €.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim propozimin që Lidhja e Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës – Dega në Mitrovicë, të mbështetet financiarisht me shumën prej 500.00 €.

Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Propozimi që Lidhja e Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës – Dega në Mitrovicë, të mbështetet financiarisht me shumën prej 500.00 € u miratua unanimitisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 10

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim vendimin për caktimin e selisë së përhershme të Muzeut të qytetit të Mitrovicës.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim vendimin për caktimin e selisë së përhershme të Muzeut të qytetit të Mitrovicës.

Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Propozim vendimi për caktimin e selisë së përhershme të Muzeut të qytetit të Mitrovicës u miratua unanimitisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 11

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim vendimin për vendosjen e pllakës përkujtimore heroit Driton Veliu.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim vendimin për vendosjen e pllakës përkujtimore heroit Driton Veliu.

Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Propozim vendimi për vendosjen e pllakës përkujtimore heroit Driton Veliu u miratua unanimitisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 12:25 min.


Mitrovicë

Procesmbajtës:


Merita PRETENI



Kryesuesi i Kuvendit


Safet KAMBERI

